

## *“Vargu i Blertë”*

Hartimi i projektit të zgjidhjes urbane të lagjes “Vargu i Blertë” ka për bazë analizën e konfiguracionit ekzistues të terrenit, ku edhe planvendosja e secilës shtëpi është bërë në harmoni me izohipset e terrenit ekzistues, gjithmonë duke plotësuar në përpikëri të gjitha kriteret urbane, arkitektonike dhe infrastrukturore të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i cili është në fuqi.

Ndër karakteristikat kryesore me të cilat shquhet “Vargu i Blertë” janë:

- Pozita tejet e favorshme gjeografike e lagjes, shtrirja gjeometrike e njësive të banimit, duke i dhënë përparësi të veçantë orientimit jugor të kthinave primare të banimit si orientimi më i përshtatshëm;
- Dominimi i gjelbërimit në lagje;
- Trajtimi urban dhe arkitektonik i lagjes, ku përmes planifikimit, qëndrueshmërisë dhe aplikimit të materialeve natyrore është arritur që lagjia të unifikohet me natyrën, duke u bërë njëkohësisht ikonë e lagjes Sofalia.

Infrastruktura rrugore e planifikuar nga Komuna e Prishtinës ofron qasje të lehtë dhe të përshtatshme të lagjes me zonat përreth dhe qytetin në tërësi, si për shfrytëzim të transportit privat, poashtu edhe atë publik. Afërsia e “Vargut të Blertë” me parkun e Taukbahçes dhe atij të Gërmisë, poashtu pozita gjeografike dominante në kuadër të lagjes, duke i ofruar banorëve gjelbërim kudo me vizura piktoreske, mund të themi që “Vargu i Blertë” si lagje e gjelbër, po jetësohet në “mushkëritë” e qytetit, duke kontribuar kështu në shëndetin dhe mirëqenien e çdo banori të lagjes.

“Vargu i Blertë” është varg zgjedhjesh së shtëpive me tipologji të ndryshme, atyre në varg me 34 njësi dhe shtëpi dyshe me 14 njësi, gjithmonë duke respektuar optimumin e parcelës për tipologjinë përkatëse të shtëpisë. Qasja në lagje bëhet nga rruga e planifikuar me 12m gjerësi, duke ofruar komoditetin e nevojshëm infrastrukturor, ndërsa qasja nëpër shtëpi do të realizohet në dy nivele të njësive. Kjo qasje është si rezultat i konfiguracionit të terrenit, ku segmenti i shtëpive në pjesën e sipërme (kryesisht me shtëpi dyshe), qasjen e kanë në nivelin më të ulët të etazhitetit, ndërsa segmenti i shtëpive në pjesën e poshtme kanë qasje në nivelin e tretë të etazhitetit.

Krahas planifikimit urb-arkitektonik në funksion dhe estetikë, rëndësi të madhe i është kushtuar edhe qëndrueshmërisë dhe eficiencës së lagjes në tërësi, duke aplikuar elemente përkatëse për arkitekturë të qëndrueshme, si kulme të gjelbërta, sistem eficient për ngrohje/ftohje, përdorim të materialeve natyrore të riciklueshme e kështu me radhë.

Stafi ynë profesional ka planifikuar çdo detaj të shtëpive nga lagjia “Vargu i Blertë”, duke i’u ofruar një lagje private, të sigurt dhe me mirëmbajtje 24h. Dizajnimi i ambienteve të jashtme është bërë në baza funksionale dhe estetike, duke ofruar rehatinë e duhur, vizurat e këndshme për sy, poashtu intimitetin dhe komoditetin e nevojshëm për çdo familje.

Lagjia “Vargu i Blertë” do funksionojë si shtëpi e madhe me shumë familje, e cila është e menduar për çdo banor dhe vizitor të saj. Krahas privatësisë së lagjes, rëndësi e madhe i është kushtuar edhe hapësirës publike, duke ofruar sipërfaqe prej x ari për shfrytëzim publik, hapësirë e cila do të shërbejë për rekreacion, aktivitete fizik e sportiv, duke promovuar socializimin e banorëve pa dallim grup-moshe, e njëkohësisht duke kontribuar në shëndetin, si fizik, poashtu edhe atë mendor të çdo banori të lagjes.

Kemi një mesazh për ju:

*Një jetë e keni, meritoni t'a jetoni shëndetshëm/dinjitetshëm!*

*Bëjeni zgjedhjen e duhur, zgjedhni “Vargun e Blertë”!*